

VAJI I BYLBYLIT- Ndre Mjeda

Pikëpamjet e Mjedës për bukurinë:

- 1) Poetët mund ta shprehin bukurinë ose duke përshkruar sendet e bukura të natyrës, ose duke krijuar vetë një send të bukur.
- 2) E bukura është e dallueshme prej gjithkujt.
- 3) Bukuria e shprehur nga poetët, vjen e përshtatur sipas modelit të së bukurës, që ata kanë në mendje.
- 4) Natyra dhe e bukura janë të pandashme nga njëra-tjetra dhe janë frymëzimi kryesor i poetëve, që kanë bërë vepra të suksesshme.

Analiza metrike e poezisë “Vaji i bylbylit”:

Poezia “Vaji i bylbylit” përbëhet nga katër pjesë dhe në total ka dyzet strofa, ku dy pjesët e para kanë nga dhjetë strofa secila, kurse pjesa e tretë dhe e katërt kanë përkatësisht shtatë dhe trembëdhjetë strofa. Strofat e tre pjesëve të para janë katër vargëshe, kurse strofat e pjesës së fundit përbëhen nga tre vargje e gjysmë. Gjysmë kjo, e cila është e njëjtë në të gjitha strofat, përveç asaj të fundit.

Për sa i përket llojit të vargut, ai është i ndryshëm në pjesë të ndryshme, por edhe vetë brenda pjesëve. Në pjesën e parë, vargjet variojnë nga katër deri në shtatë rrokësh, por më së shumti hasen ata katër rrokësh e më pas pesë rrokësh.

Pjesa e dytë ka vargje gjashtë deri në dhjetë rrokësh, me dominancë të tetë rrokëshit. Vargjet e pjesës së tretë shkojnë nga shtatë deri në njëmbëdhjetë rrokësh dhe mbizotërues është vargu me nëntë rrokje. Në pjesën e fundit, gjysmëvargjet janë gjashtë rrokësh, kurse vargjet e tjera kanë dhjetë deri në katërmëdhjetë rrokje dhe më i shpeshti është njëmbëdhjetë rrokëshi e më pas dhjetë rrokëshi.

Rima, gjithashtu ndryshon sipas pjesëve. Në pjesën e parë, kemi rimë mes vargut të dytë dhe të katërt të çdo strofe, por edhe përsëritje të zanoreve: *a, e, i, o, u, y* dhe bashkëtingëlloreve: *r, rr*, si edhe të vargjeve të ndryshme, por edhe të vetë strofave.

Rima e pjesës së dytë realizohet mes vargut të dytë dhe të tretë të çdo strofe dhe vargjeve të fundit të çdo dy strofave. Në pjesën e tretë kemi rimë të kryqëzuar ABAB, kurse rima e pjesës së fundit është e puthur AABB.

Analiza stilistike:

“Vaji i bylbylit” është një poezi e pasur me figuracion letrar. Së pari, vlen të përmendet **inversioni**, që haset shpesh në tekstin e kësaj poezie. Anasjella është përdorur me synimin

për të mëshuar te fjalët kyçe, fjalët më të rëndësishme që e bëjnë më të qartë kuptimin e vjershës.

Dendur gjendet edhe **kontrasti**, si ai mes fjalëve, ashtu edhe ai kontekstual. Si romantik, Mjeda përdor natyrën nga njëra anë dhe qenien njerëzore me botën e tij shpirtërore nga ana tjetër, për të realizuar kontrastin. Kontrastet në poezi rrisin dramaticitetin e për pasojë e bëjnë më të dukshëm mesazhin.

Poezia është ndërtuar mbi bazën e **simbolit**. Duke qenë se është poezi lirike dhe poeti romantik i frymëzuar nga natyra, është përdorur bilbili, këngëtari i lirisë, si simbol i unit lirik të autorit.

Figura të tjera, që gjenden në poezi janë **pyetjet retorike**, për të shprehur trazirat shpirtërore dhe dilemat e poetit dhe **retiçencat**, që thyjnë vargjet dhe i lënë mendimet të hapura. Është përdorur **apostrofi** për ta thirrur sa më pranë, atë çka autori ka nevojë. Gjithashtu, në poezi janë përdorur edhe **epitete**, **metafora** e **anafora**.

Mesazhi:

Liria është ndjenja që u përket atyre njerëzve, të cilët edhe pse e ndiejnë mungesën shtrënguese të saj, kanë shpresën, besimin, optimizmin, dëshirën dhe vullnetin se do të mund ta fitojnë atë, pavarësisht çdo pengese.

Shpjegimi:

Bylbyli i Mjedës është një copëz, që simbolizon unin lirik të vetë poetit. Autori e krahason mungesën e lirisë me bylbylin e burgosur në kafaz. Shpendi i bukur dhe këngëtar ndjen natyrën që po çel, e cila e thërret në gjirin e saj. Ajo i zgjon dëshirën dhe optimizmin për tu ngritur, për t'i luftuar pengesat, për të qenë i lirë. Dhe ai që vërtetë e ndjen mungesën e lirisë mund ta gjejë guximin e duhur, i cili vjen si pasojë e optimizmit. Mjerimi dhe e keqja na shpalosen në forma nga më të ndryshmet. E rëndësishme është të duam t'ia dalim edhe të presim, sepse koha shëron çdo plagë.